




REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVO
Kuvendi Komunal Dragash – Skupština Opštine Dragaš – Municipality of Dragash

Zyra e Kryetarit
Kancelarija Predsednika
Office of Mayor

Datë/a:	17.01.2017
Referenca:	02 Br.br.
Për/Za/To:	Drejtorët e drejtorateve të Komunës-Dragash
CC:	
Përmes/Preko/Trough:	Zyrës së Dshërbimit të Kuvendit-Dragash
Nga/Od/From:	z.Salim Jenuzi, Kryetar i Komunës Dragash 
Tema/Subjekat/Subject:	Urgjencë...

Të nderuar drejtorë,

Meqenëse afati i kërkuar për dorëzimin e Raporteve të Punës për vitin 2016 dhe i Planeve të Punës për vitin 2017 ka skaduar, **URGJENTISHT** kërkoj që materialet e kërkuara t'i dërgoni në Shërbimin e Kubvendit të Komunës-Dragash **deri më dt.20.01.2017 (e premte)**, sepse kjo vonesë po shkakton pengesa në mbajtjen e seancës së paraparë të Kuvendit Komunal-Dragash konform afatit ligjor të Ligjit për Vetëqverisje Lokale.

Me shpresë për mirëkuptim, Ju përshëndesim !

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT (MM)

z. Salim Jenuzi

Kryetar i Komunës së Dragashit

dhe

z. Adrian Zeqiri

Drejtor i Qendrës Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI Kosova)

Duke marrë parasysh që e drejta për arsimim është një e drejtë themelore e njeriut;

Duke marrë parasysh miratimin e dokumenteve që kanë për qëllim të krijojnë një sistem arsimor gjithëpërfshirës, me mundësi të barabarta dhe edukim cilësor për të gjithë fëmijët e Republikës së Kosovës, përfshirë Planin strategjik të arsimit të Kosovës (2011—2016) dhe dokumentin e ri të Planit strategjik të arsimit të Kosovës (2017—2021), Udhëzimin administrativ 19/2012 për Krijimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e obliguar (EPRBM) si dhe Doracakët për EPRBM-të komunale dhe shkollore dhe Planin kombëtar të veprimit kundër braktisjes dhe mos-regjistrimit të shkollës 2016—18;

Duke marrë parasysh obligimet dhe përgjegjësitë ligjore të institucioneve publike për sigurimin e mundësive të barabarta në arsim për çdo fëmijë dhe për të respektuar parimin e edukimit gjithëpërfshirës të fëmijëve dhe vendosjen e tyre, pavarësisht nga gjendja e tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore apo kushteve të tjera dhe duke promovuar integrim dhe kontakt në mes të fëmijëve;

Duke pranuar që komunat ushtrojnë kompetenca të plota në ofrimin e arsimit publik parashkollor, arsimin fillor dhe të mesëm;

Duke pranuar kontributin e shquar të ECMI Kosovës në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të grupeve të cenuara dhe të marginalizuara, veçanërisht në fushën e arsimit; dhe suksesin e dëshmuar në ofrimin e ndërtimit të kapaciteteve dhe mbështetje institucionale për zyrtarët komunalë dhe personelin shkollor;

Ky Memorandum i Mirëkuptimit krijon një marrëveshje pune midis Komunës dhe ECMI Kosovës për të zvogëluar numrin e fëmijëve që janë jashtë sistemit shkollor, fëmijëve që kanë braktisur shkollën apo janë në rrezik të braktisjes së shkollimit dhe ndërtimit të kapaciteteve të zyrtarëve komunalë dhe EPRBM-ve përmes programit “Zhvillimi i kapaciteteve për forcimin dhe ngritjen e rezultateve në rritjen e qasjes dhe vazhdimin të vijimit të arsimit për fëmijët e cenuar dhe të marginalizuar”. Programi është zbatuar që nga maji 2013 dhe në nëntor të vitit 2016 hyn në fazën e tij të tretë. Programi është mbështetur dhe financuar nga UNICEF dhe bashkë-financuar e zbatuar nga ECMI Kosova në

bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Periudha e implementimit të aktiviteteve të projektit zgjat deri në nëntor të vitit 2017 dhe synon të gjitha komunat në Kosovë.

Komuna dhe ECMI Kosova në bashkëpunim me MASHT-in do të bashkëpunojnë në mënyrat si më poshtë:

1. ECMI Kosova do të mbështesë zyrtarët komunalë gjatë themelimit dhe funksionimit EPRBM-ve komunale dhe shkollore, ECMI Kosova do të mbështesë EPRBM-të në identifikimin dhe regjistrimin e fëmijëve jashtë shkolle, zbatimin e mekanizmeve për integrim dhe ndërhyrje parandaluese dhe me sistemin e menaxhimit të rastit, monitorimin e fëmijëve jashtë shkolle. Për më tepër, ECMI Kosova do të mbështesë EPRBM-të komunale gjatë zhvillimit, zbatimit dhe rishikimit të planeve të veprimit me qëllim të zvogëlimit të numrit të fëmijëve jashtë shkolle, fëmijëve që kanë braktisur shkollën apo fëmijëve që janë në rrezik të braktisjes së shkollimit me qëllim të rritjes së qasjes dhe mbajtjes së tyre në arsim.
2. ECMI Kosova do të ofrojë trajnime për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë dhe EPRBM-ve për identifikimin dhe regjistrimin e fëmijëve jashtë shkolle, menaxhimin e rasteve, monitorimin dhe rishikimin e efektivitetit të veprimeve të ndërmarra dhe planifikimin/zhvillimin e planeve të veprimit komunal që kanë për qëllim parandalimin e braktisjes së shkollës.
3. Komuna do të bashkëpunojë me ECMI Kosovën dhe do të ofrojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të dhënat në dispozicion për ECMI Kosovën dhe do të ofrojë personel i cili do të jetë në dispozicion për të siguruar zbatimin efektiv të programit. Veç kësaj, komuna do të sigurojë hapësirë dhe lokacion për mbajtjen e seancave trajnuese;
4. Komuna zotohet të miratojë planin e veprimit komunal dhe ti aplikojë mekanizmat dhe instrumentet me qëllim të zvogëlimit të numrit të fëmijëve jashtë shkolle si dhe të ndikojë në rritjen e qasjes dhe mbajtjes së fëmijëve në arsim;

Nënshkruar më: 19.01.2017

Në emër të Komunës së Dragashit

z. Salim Jenuzi



Kryetar i Komunës së Dragashit

Në emër të ECMI Kosova

z. Adrian Zeqiri

Drejtor i ECMI Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragash

02 Nr. Br. CD/01-470/17

19.01.2017

Dragash - Dragash



Republika e Kosoves
Republika Kosova
Republic of Kosovo

- Kryetari i Komunës

02 Nr.353/01-556/17

Dt.20.01.2017

D r a g a s h



Komuna Dragash
Opština Dragas
Municipality Dragas

K O N T R A T Ë

MBI SHFRYTËZIMIN E PRONËS SË PALUAJTËLSHME KOMUNALE(DRAGASH), PËR QËLLIME TË POSAÇME

E nënshkruar më dt.23.01.2017 në mes të Kryetarit të Komunës-Dragash, si përfaqësues i Komunës së Dragashit, në njerën anë (në tekstin e mëtejshëm „dhënësi i shfrytëzimit të pronës së paluajtëshme të Komunës“) dhe NPN „Renelual Tahiri“ Sh.p.k.Prizren, të cilën e përfaqëson Refki Hoxha,drejtor, si pranues i shfrytëzimit, në anën tjetër(në tekstin e mëtejshëm „pranues i shfrytëzimit të pronës së paluajtëshme të Komunës“).

ILËNDA E SHFRYTËZIMIT,PERIUDHA E SHFRYTËZIMIT DHE ÇMIMI I SHFRYTËZIMIT

Neni 1.

Në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal të Dragashit për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtëshme të Komunës, për raste të posaçme 01 Nr. 06-22263/2 të dt.14.12.2016, Komuna i jep në shfrytëzim pronën e paluajtëshme të Komunës NPN „Renelual Tahiri“ Sh.p.k. Prizren, Komuna e Prizrenit, dhe atë këto paluajtëslimëri:

- në tërësi, parcela kadastrale P-70604030-00011-0, tokë bujqësore (klasa livadh) me sipërfaqe prej 1585 m/2, ZK Orçusha,
 - pjesa e parcelës kadastrale P-70604038-01128-0, pronë ndërtimore (shtëpi-mdërtesë) në sipërfaqe prej 26 m/2, ZK Shajne,
 - pjesa e parcelës kadastrale P-70604032-01183-0, tokë bujqësore (kullosë kl.3-të) me sipërfaqe prej 623 m/2, ZK Pllava II, dhe
 - pjesa e parcelës kadastrale P-70604032-01125-0, tokë bujqësore (kullosë kl.4-të) me sipërfaqe prej 29 m/2, ZK Pllava.
- me qëllim të ndërtimit të gypërçuesit për nevojat e hidrocentraleve.

Neni 2.

Prona e paluajtëshme e përcaktuar me nenin 1. të kësaj Kontrate jepet në shfrytëzim për periudhën prej 20 (njëzetë) viteve dhe kjo Kontratë hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit dhe vërtetimit para organeve kompetente.

Neni 3.

Palët kontraktuese janë të pajtimit se për periudhën e vlefshmerisë së Kontratës, të përcaktuar me nenin 2 të kësaj Kontrate, ajo mund të vazhdohet me kushtet e paqapara me këtë Kontratë.

Neni 4.

Shfrytëzuesi ka të drejtën e përparësisë në krahasim me personat tjerë në periudhën e vazhdimit të shfrytëzimit me kusht se i ka respektuar të gjitha kushtet, kushtet dhe obligimet e parapara me Kontratë. Shfrytëzuesi i pronës së paluajtëshme është i detyruar që për qëllimet e veta të vazhdon periudhën e vlefshmerisë së kësaj Kontrate dhe të lajmëron , me shkrim, Dhënësin e shfrytëzimit më së voni 6 (gjashtë) muaj para skadimit të afatit të vlefshmerisë të së njejtës. Pas pranimit të lajmërimit, Dhënësi i shfrytëzimit është i obliguar që, për vendimin e vetë, t'a njofton Shfrytëzuesin e pronës së paluajtëshme në afat prej 3 (tre) muajëve nga dita e pranimit të lajmërimit. Me Kontratë të re, me pëlqimin e të dy palëve kontraktuese, do të rregullohen kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtëshme.



Neni 5.

Dhënësi i shfrytëzimit, me nënshkrimin e kësaj Kontrate, i garanton Shfrytëzuesit se në pronën e paluajtëshme në fjalë nuk ka ngarkesa apo kufizime të cilat mund të pamundësojnë ndërtimin e objekteve.

Neni 6.

Shfrytëzuesi e merr në shfrytëzim pronën e paluajtëshme në fjalë të përcaktuar me nenin 1 me të gjitha kushtet dhe kufizimet e cekura në këtë Kontratë.

Neni 7.

Shfrytëzuesi është i obliguar që, në emër të shfrytëzimit të pronës së paluajtëshme në fjalë, çdo muaj, Dhënësit të shfrytëzimit (Komunës së Dragashit) t'i paguan çmimin i cili në nivel vjetor është **930,12 euro (nëntqindë e tridhjetë euro e dyndhjetë cent).**

Çmimi mujor i shfrytëzimit paguhet deri në dt.5 të muajit për muajin vijues dhe çmimi mujor është **77,51 euro (shtatdhjetë e shtatë euro e pesëdhjetë e një cent).**

Shuma e parë mujore e çmimit mujor të shfrytëzimit të pronës së paluajtëshme të Komunës është përlllogaritur, nga muaji vijues, nga dita e nënshkrimit të Kontratës.

Shfrytëzuesi është i obliguar që çmimin t'a paguan në afatin e cekur-pa paralajmërim të posaçëm apo kërkesë Dhënësin e shfrytëzimit (Komunën e Dragashit).

II. KUSHTET E PËRGJITSHME TË SHFRYTËZIMIT**Neni 8.**

Palët kontraktuese, me pëlqim, konstatojnë se kushtet e përgjithshme të parapara me këtë nen janë obligative për Shfrytëzuesin e pronës së paluajtëshme të Komunës dhe përcellësit juridik gjatë vlefshmerisë së kësaj Kontrate:

- Dhënia me qira e pronës së paluajtëshme në fjalë të Komunës, personit tjetër nga ana e Shfrytëzuesit,
- Ndërtimi i objekteve me rastin e sigurimit të lejes për ndërtim nuk është e lejuar, pos në rastet e parapara me Ligjin për planifikimin e ndërtimit.

III. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E PALËVE KONTRAKTUESE**Neni 9.**

Obligimet e qiramarrësit janë:

- të paguan çmimin e shfrytëzimit për pronën e paluajtëshme në fjalë Komunës në mënyrën dhe afatet e parapara me këtë Kontratë,
- që pronën e paluajtëshme në fjalë të Komunës t'a shfrytëzon në harmoni me destinacionin për të cilin është e mundur të sigurohet leja për ndërtim e në harmoni me kushtet urbanistike në zonën e cila gjendet trolli gjatë vlefshmerisë së kësaj Kontrate,
- që të mirëmban në gjendje të mirë pronën e paluajtëshme në fjalë të Komunës e në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi dhe standardet e sigurisë, si dhe të kryen të gjitha riparimet e nevojshme, pa kurrfar obligime financiare për Dhënësin e shfrytëzimit të pronës së Komunës,
- që, me përfundimit të ndërtimit të objektit, të siguron lejen e përdorimit në harmoni me dispozitat në fuqi dhe objektin në fjalë t'a regjistron në librat publike për evidencë të paluajtëshmerisë, si dhe Drejtorisë komptente Tatimore t'i paraqes tatimin në pronë,
- të paguan të gjitha kompenzimet, taksat dhe obligimet tjera që dalin me rastin e ekzekutimit të kësaj Kontrate dhe që me kërkesën e Dhënësi të shfrytëzimit (Komunës së Dragashit) të dorëzon dëshminë për pagesën e tyre,
- që, në rast të vonesës me pegesë të çmimit të paraparë për shfrytëzim me këtë Kontratë, të paguan ndëshkimet, për çdo ditë të vonesës, në lartësi prej 1% të çmimit të përlllogaritur mujor të shfrytëzimit, nëse çmimin e paguan çdo muaj.

Neni 10.

Obligimet e Dhënësit të shfrytëzimit-Komunës së Dragashit, janë:

- Përgjegjësia për mangësitë materiale
- Përgjegjësia për mangësitë juridike

2018/05/10
 DRASHIT
 KOMUNË

Neni 11.

Dhënësi i shfrytëzimit-Komuna Dragash është e obliguar që të largon mangësitë materiale për pronën e paluajtëshme në fjalë të Komunës për të cilat, pjesërisht apo në tërësi, nuk ka mundësi shfrytëzimi saj, pavarësisht se ato mangësi a do të dihen ose jo në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

Neni 12.

Në rastet e mangësive juridike në pronën e fjalë të Komunës:

1. Kontrata për shfrytëzimin e pronës së paluajtëshme të Komunës priset sipas ligjit,
2. Me përzgjedhjen e Shfrytëzuesit të pronës së paluajtëshme të Komunës, Kontrata për shfrytëzimin mund të priset, apo mund të kërkohet zvogëlim i çmimit të shfrytëzimit nëse, personit të tretë, i takon ndonjë e drejtë e cila kufizon të drejtën e Shfrytëzuesit të pronës së paluajtëshme të Komunës.

Neni 13.

Dhënësi i Shfrytëzimit të patundshmërisë së Komunës është i pajtimit që Shfrytëzuesi i pronës së paluajtëshme të Komunës që, të drejtën e shfrytëzimit të paluajtëshmerisë në fjalë, t'a regjistron në emrin e vetë (si shfrytëzues) në librat publike për evidentimin e paluajtëshmerisë pa pëlqim të posaçëm apo prezencë të Dhënësit në shfrytëzim-Komunës së Dragashit.

I. SKADIMI I KONTRATËS**Neni 14.**

Kjo Kontratë skadon:

1. Me skadimin e kohës së përcaktuar me nenin 2 të kësaj Kontrate,
2. Shkëputjen e Kontratës të njerës nga palët kontraktuese,
3. Shkëputjen e Kontratës.

V. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**Neni 15.**

Palët kontraktuese të gjitha kontestet do t'i zgjidhin në mënyrë paqësore, kurse, në të kundërtën, kompetente është Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Dragash.

Neni 16.

Pjesë përbërëse e kësaj Kontraje janë:

1. Vendimi për Dhënien në Shfrytëzim të pronës së paluajtëshme të Komunës, në raste të posaçme 01 Nr.06-22263/2 e dr.14.12.2016,
2. Çertifikata për të drejtën e pronësisë, për secilën parcelë kadastrale, dhe
3. Kopja e planit, për secilën parcelë kadastrale.

Neni 17.

Palët kontraktuese janë dakorduar që tatimin për bartje të së drejtave absolute-sipas kësaj Kontrate, si dhe shpenzimet e vërtetimit të kësaj Kontrate, të bien në barrë të Shfrytëzuesit të pronës së paluajtëshme të Komunës.

Neni 18.

Kjo Kontratë është përpluar në 6 (gjashtë) kopje të njejta nga të cilat, nga 2 (dy) kopje mban secila palë, kurse 2 (dy) kopje i dorëzohen organit kompetent të Komunës Dragashit për regjistrim të Kontratës për shfrytëzimin e pronës së paluajtëshme të Komunës (Drejtoratit për Financa, Ekonomi e Buxhet-Seksionit të Ekonomisë).

PALET KONTRAKTUESE :

Kryetari i Komunës Dragash
Salim Jemini



NPN „Renelual Tahiri“ Sh.pk.Prizren
Refki Hoxha drejtor





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVO
Kuvendi Komunal Dragash – Skupština Opštine Dragaš – Municipality of Dragash

Zyra e Kryetarit
Kancelarija Predsednika
Office of Mayor

Datë/a:	27.01.2017
Referenca:	02 Nr.
Për/Za/To:	Drejtorët e drejtorateve & Menaxherin e Personelit të Komunës-Dragash
CC:	
Përmes/Preko/Trough:	Zyrës së Shërbimit të Kuvendit-Dragash
Nga/Od/From:	z.Salim Jenuzi, Kryetar i Komunës-Dragash
Tema/Subjekat/Subject:	Kërkesë për ndërmarrje të masave k...

Të nderuar drejtorë & Menaxher i Personelit...,

Meqenëse jemi në fillim të vitit kalendarik, kërkoj nga Ju që të ndërmerrni masat e nevojshme, për këto çështje, si në vijim:

- 1.Që të analizoni e shiqoni të gjitha vendet e punës në kuadër të drejtoratit tuaj kompetent dhe në bashkëpunim me Menaxherin e Personelit të Komunës-Dragash, me kohë, të shpallen konkurset, me kriteret e nevojshme për plotësimin e tyre,
- 2.Që për punëtorët që gjenden në pushime mjekësore të veprohet sipas dispozitave ligjore në fuqi, dhe
- 3.Që ndaj punëtorëve, nën masa disciplnore, të veprohet sipas masave të shqiptuara të Komisionit Dicipliore dhe masave tjera të dispozitave ligjore për këtë çështje.

Me shpresë për mirëkuptim, Ju përshëndesim !



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine
Dragaš/Dragas Municipality



- Kryesuesi i KK-së
01 Nr. 020/01-2131
Dt. 16.02.2017
D r a g a s h

TH I R R J E

Për pjesëmarrje në seancën e II-të (dytë)/2017 të Kuvendit Komunal të Dragashit e cili do të mbahet më 28.02.2017 (e martë), në sallën e KK-së të Dragashit, duke filluar në ora 10⁰⁰.

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 31 të Statutit të Komunës-Drageash, Kryesuesi i KK-së Dragash KONVOKON seancën e II-të (dytë)/2017 të Kuvendit Komunal të Dragashit dhe propozon këtë :

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit, nga seanca e I-rë/2017 e Kuvendit,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës së Kryetarit (Ekzekutivit) të Komunës-Drageash, për vitin 2016 & Planeve të Punës, për vitin 2017,
3. Njoftimi me Raportin e Punës së KKS-së, për vitin 2016 & Planit të Veprimt, për vitin 2017,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i P/Vendimit për rritjen e buxhetit, nga të hyrat vetanake, për vitin 2016, dhe
5. Eventuale...

Shtojcë : Materiali për pikat 1, 2, 3 dhe 4 të rendit të ditës...



Me respekt !
KUVENDI KOMUNAL DRAGASH
Kryesuesi
Shaban Shabani, d.v.